

**Nr. Prot. 051/B/18**

## VENDIM Nr. 1252

Për

**Vazhdimin e Procesit të Konsultimit Publik të dokumenteve për Analizën e Tregjeve  
“Qasja me shumicë bashkëshfrytëzimi -LLU (duke përfshirë qasjen e ndarë) në laqet  
metalike dhe nën-laqet me qëllim ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike  
dhe  
qasja me shumicë brezgjere (broadband)”**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 04/L-109 për Komunikime Elektronike, neni 10, paragrafi 5), neni 31, paragrafi 8), neni 79, paragrafi 1) dhe 2) dhe neni 82 paragrafi 1) dhe 3) (*tutje referuar si - Ligji*); Rregullores Nr. 27 për Analizat e Tregut (*Ref. ARKEP Nr. Prot. 041/B/14*), neni 3, paragrafët 1), 3) dhe 4), neni 4, paragrafët 3.8) dhe 3.9) (*tutje referuar si; Rregullorja për Analizat e Tregut*) dhe neni 13 paragrafi 1) dhe 5) i Statutit të (*Ref. Nr.Prot.054/B/17*) të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (*tutje referuar si; ARKEP ose Autoriteti*), Bordi Drejtues i Autoritetit në përbërje prej:

- 1) z. Kreshnik Gashi Kryetar
- 2) z. Nijazi Ademaj Anëtar
- 3) z. Hazir Hajdari Anëtar

pas shqyrtimit të kërkesës së operatorit IPKO Telecommunications LLC (*tutje referuar si - IPKO*), si dhe Rekomandimit të Departamentit të Komunikimeve Elektronike (DKE), mori këtë:

## V E N D I M

- I. Miratohet vazhdimi i Konsultimit Publik të:
  - a) Draft Vendimi për Definimin e Tregut Qasja me Shumicë brezgjere;
  - b) Draft Vendimi për Definimin e Tregut Qasja me shumicë bashkëshfrytëzimi -LLU (duke përfshirë qasjen e ndarë) në laqet metalike dhe nën-laqet me qëllim ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike;
  - c) Draft Vendimi për Përcaktimin e ndërmarrjes Telekomi i Kosovës Sh.A. si OFNT në tregun Qasja me shumicë bashkëshfrytëzimi -LLU (duke përfshirë qasjen e ndarë) në

laqet metalike dhe nën-laqet me qëllim ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike;

- d) Draft Vendimi për Përcaktimin e ndërmarrjes IPKO Telecommunications LLC si OFNT në tregun e qasjes me shumicë brezgjërë;
- e) Raporti për analizën e tregjeve dhe përcaktimi i operatorëve në fuqi të ndjeshme në treg - Qasja me shumicë bashkëshfrytëzimi -LLU (duke përfshirë qasjen e ndarë) në laqet metalike dhe nën-laqet me qëllim ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike dhe qasja me shumicë brezgjërë (broadband);

II. Procesi i konsultimit publik vazhdohet nga data **23 Gusht 2018** dhe përfundon më datë **24 Tetor 2018**.

III. Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

### ARSYETIM

Ligji, respektivisht neni 10, paragrafët 5) përcakton se Autoriteti: *“Miraton vendimet në lidhje me përcaktimin e tregjeve përkatëse, kryen analizat e tregut dhe imponimin, si dhe tërheqjen e obligimeve të rregullatorit tek operatorët me fuqi të ndjeshme tregu.”*

ARKEP, me vendimin Nr. 1178 (Ref. Nr.Prot.025/B/18) të datës 23 Prill 2018 ka filluar procesin e konsultimit me palët e interesit të draft vendimeve nga analiza e tregjeve:

- Qasja me shumicë bashkëshfrytëzimi-LLU (duke përfshirë qasjen e ndarë) në laqet metalike dhe nën-laqet me qëllim ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike dhe
- Qasja me shumicë brezgjërë (broadband);

Sipas vendimit në fjalë konsultimi zgjatë nga 23 Prill 2018 deri më 22 Maj 2018. Më datë 14 Maj 2018, operatori IPKO i ka dërguar shkresë ARKEP (Ref. Nr.Prot. 482/2/18), përmes së cilës ka kërkuar shtyrjen e afatit të konsultimit edhe për së paku 90 ditë me arsyetimin se janë të angazhuar intensivisht në projektin e implementimin e kodit telefonik 383. Bordi i ARKEP me Vendimin nr. 1195 (Ref. Nr.Prot. 031/B/18; dt.22/05/2018) ka miratur vazhdimin e konsultimit deri më datë 22 Gusht 2018.

Megjithatë, duke e ditur rëndësinë e Raportit për Analizën e tregjeve dhe përcaktimin e operatorëve në fuqi të ndjeshme si dhe duke marrë për bazë ndërlíkueshmërinë në procesin e përgatitjes së komenteve, operatorët IPKO dhe Telekom i Kosovës më datë 14 Gusht 2018 kanë kërkuar (Ref. e-mail: Tuesday, August 14, 2018 3:29 PM) mirëkuptimin e ARKEP në zgjatjen e afatit për dorëzimin e të komenteve së paku për periudhë shtesë 2 mujore gjegjësisht deri më 24 tetor 2018.

Neni 82 paragrafi 1) i Ligjit përkufizon se Autoriteti gjatë aprovimit të akteve normative duhet t'i publikojë ato në pajtim me kushtet dhe procedurat e vendosura nga Autoriteti, duke ua ofruar mundësinë personave të interesuar që në **afat të arsyeshëm kohor** të shprehin pikëpamjet e tyre. Pra, është në diskrecionin e ARKEP për të vendosur rreth afatit të arsyeshëm kohorë për konsultim me palët e interesit.

Andaj, është vendosur sikurse në dispozitiv të këtij vendimi.

#### **Këshilla Juridike:**

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit.

**Prishtinë, 26/09/2018**

### **Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare**

**Kreshnik Gashi**  
**Kryetar i Bordit**

#### **Aktvendimi i dërgohet:**

- Operatorëve të rrjetit dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike;
- Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik/Departamenti i Postë Telekomunikacionit dhe Teknologjisë Informative
- Autoritetit Kosovar të Konkurrencës
- Departamentit të Komunikimeve Elektronike/Zyra për Analiza Ekonomike, ARKEP,
- Departamenti ligjor, ARKEP,
- Arkivit, ARKEP